



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punijena / Predato Received / Delivery	14. 01 2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organi / Jednica Org. / Unit	In Proti In Proti Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUMSHACK	168/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1183/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca, dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Sabile Avdyli, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.2240/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën A.nr 356/2019 të datës 26.06.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë kundër Vendimit me numër protokollit 533-1 të datës 11.04.2019 të U.d Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, në çështjen juridike "Pezullim parandalues", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 13.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën A.nr.356/2021 të datës 26.06.2019 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, tani Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në pozitën e punës Zyrtare e Prokurimit, me datë 26.06.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2855/19, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me numër protokollit 533-1 të datës 11.04.2019 të U.d Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike për pezullim parandalues me pagesë deri në tre (3) muaj, në pritje të një hetimi nga Komisioni Hetimor.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 26.08.2019 përmes shkresës zyrtare me numër protokollit 3865 ka njoftuar anësuesen lidhur me pamundësinë e shqyrtimit të ankesës A.nr.356/2021 të datës 26.06.2019, për shkak të mungesës së korumit për vendosje, duke udhëzuar të njëjtën me të drejtën e inicimit të padisë në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Sipas padisë së ankueses, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 10.11.2021 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.2240/19, të pranuar nga ana e Këshillit me datë 16.12.202, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, ka anuluar njoftimin e Këshillit të datës 26.08.2019 si dhe ka detyruar të njëjtin që brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh të vendos për ankesën e ankueses A.nr.356/2019 të datës 26.06.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Aktgjykimin A.nr.2240/19 të datës 16.12.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative; E-mail i datës 30.12.2021 lidhur me pranimin e prova shtesë sipas Aktgjykimit të datës 16.12.2021" Aktvendimin me numër protokolli 1501 te datës 27.08.2019, të KZKA-së, Vendimi nr. Protokolli 1315 të Komisionit Disiplinor të datës 18.07.2019; Ankesën me numër protokolli 2855/2019/2019 të datës 26.06.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimin me numër 384/2013 të datës 16.05.2013; E-mail zyrtar i datës 04.04.2019 ftesë për pjesëmarrje nga Kryetarja e Lidhjes së Mësuesve Shqiptarë në Itali; Vendimin me numër 533-1, për pezullim parandalues i datës 11.04.2019 të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike; Vendimin me numër 730 per themelimin e Komisionin Hetimore; Kërkesë e datës 11.04.2019 nga Udhëheqja e drejtpërdrejtë e ankueses; Ankesa e datës 10.05.2019 për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike; Ftesën e datës 29.03.2019; E-mail i datës 11.06.2019, E-mail i datës 12.06.2019, E-mail i datës 13.06.2019 (me pyetje nga Komisioni Hetimor); E-mail i datës 26.06.2019; Përgjigjen në ankesë të datës 04.07.2019; Njoftimin e datës 13.06.2019; Kërkesën për udhëtim zyrtar; Procesverbalin e datës 13.06.2019; Fotografi të nxjerra nga rrjeti social-facebook ; Kërkesën e datës 11.04.2019; Njoftimin nr.1140 të datës 02.07.2019; Njoftimin nr.1139-1 të datës 02.07.2019; Njoftim nr.1138 të datës 02.07.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që objekti i ankesës A.nr.356/2019 i datës 26.06.2019 e parashtruar nga ankuesja *është bërë i pamundur për vendosje, sepse,*

Nga administrimi i shkresave, përkatësisht sipas Akt Emërimit me numër 384/2013 të datës 16.05.2013, rezulton se ankuesja *është e punësuar Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike (tutje MDIS) në pozitën e punës Zyrtare e Prokurimi.*

Ankuesja me datë 04.04.2019 përmes E-mailit zyrtar, kishte pranuar ftesë nga Kryetarja e Lidhjes së Mësuesve Shqiptarë në Itali, për pjesëmarrje në seminarin e datës 12.04.2019 dedikuar Kosovës, territorit dhe arkeologjisë së saj, i planifikuar të mbahej në Itali. Pas kësaj ftese ankuesja plotëson kërkesën për udhëtim zyrtar, të cilën kërkesë e aprovon edhe udhëheqësja e saj e drejtpërdrejt me datë 11.04.2019.

Po në të njëjtën ditë gjegjësisht me datë 11.04.2019, Mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë ka parashtruar kërkesë numër 533 tek U.d. Sekretarja e Përgjithshme e MDIS-së, për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses, për shkak të shkeljes së detyrave të punës respektivisht tejkalim të kompetencave sipas Rregullores Nr.04/11 për Procedurën Disiplinore në Shërbimin Civil. Ndërsa U.d Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 533-I, për pezullim parandalues me pagesë për periudhën deri në tre (3) muaj, duke filluar nga data 12.04.2019 në pritje të një hetimi nga Komisioni Hetimor, kurse me

datë 13.05.2019 përmes Vendimit me numër protokollit 730 ka themeluar Komisionin Hetimor në përbërje nga tre anëtarë, me kompetencë që të hetoj veprimet e supozuara si të jashtëligjshme të kryera nga ankuesja në cilësinë e zyrtares së prokurimit.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me numër 533-I të datës 11.04.2019, ka parashtruar ankesë me datë 10.05.2019 me numër protokollit me 02/724, në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të MDIS-së. Ky i fundit, nuk ka shqyrtuar ankesën e ankueses së datës 10.05.2019, kështu që ankuesja pas heshtjes administrative të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë 26.06.2019, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2855/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore se Vendimi me numër protokollit 533- I i datës 11.04.2019 për pezullimin parandalues është i padrejtë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të shkresave të lëndës përkatësisht provave shtesë të dërguara nga organi i punësimit me datë 30.12.2021, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i MDIS-së, me Vendimin me numër protokollit 135 të datës 18.07.2019, ka shpallur ankuesen përgjegjëse për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 5 paragrafi 4 dhe nenit 19 të Rregullores Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil, duke shqiptuar ndaj të njëjtës masën disiplinore "Pezullim i detyrave dhe ndalimi i 1/3 të pagës në kohëzgjatje prej një (1) muaji". Ndërsa, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, duke vendosur sipas ankesës të datës 01.08.2019 të parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit me numër protokollit 135 të datës 18.07.2019 të Komisionit Disiplinor, me Aktvendimin me numër protokollit 1501 të datës 27.08.2019 ka pezulluar çështjen kryesore, në pritje të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil lidhur me ankesën e ankueses të parashtruar me datë 26.06.2019.

Bazuar në të gjeturat si me lart si dhe duke marrë parasysh faktin se procedura disiplinore e iniciuar ndaj ankueses ka përfunduar me vendim meritore të Komisionit Disiplinor, Kolegji konstaton se Vendimi i Komisionit Disiplinor me numër protokollit 135 i datës 18.07.2019, ka konsumuar Vendimin me numër protokollit 533/1 të datës 11.04.2019 për pezullim parandalues të ankueses, si rrjedhojë Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.356/2019 i datës 26.06.2019 kundër vendimit për pezullim parandalues, është bërë i pamundur për vendosje. Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: "Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot" Kolegji vendosi të përfundojë procedimin administrativ të iniciuar me ankesën A.nr.356/2019 të datë 26.06.2019 të parashtruar nga ankuesja

Kështu që, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës si dhe bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.356/2019

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Ardita Haxhnikaj
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative;
- Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Jashtësme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personalit në Ministrinë e Punëve të Jashtësme dhe Diasporës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

